



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/SGS

Datë: 29.12.2020

Procesverbal

i mbledhjes se IX (nëntë) të rregullt për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa
REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/1154 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për vazhdimin e shërbimeve të varrimit për banorët e Komunës së Malishevës për vitin 2021.
3. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/1155 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike.
4. Raporti i Drejtorisë për Urbanizëm, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2020.
5. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.
6. Shqyrtimi i kërkesave.
7. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 18.11.2020 duke filluar në ora 13:50, morën pjesë 7 anëtarë të KPF-së, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve lidhur me materialin e mbledhjes e keni vetëm se për raportin e Drejtorisë për Urbanizëm drejtori me kanë thënë se në mbledhje do ta sjelli materialin por nuk e ka sjellur. Sot e kemi edhe Draft-Rregulloren për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, tani ka kaluar edhe debatin publik, zyrtaren për barazi gjinore Vera Bytyqin e falënderoj pasi që tërë kohën është marrë deri në përfundim të debatit publik dhe tani me ka thënë se të gjitha propozimet i ka futë draft Draft rregullore. Mirë ka qenë tani ta rekomandojmë për Kuvend, mbasi i ka kaluar të gjitha procedurat.

Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht të gjithë ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Rahim Morina: Kush jeni për miratim të procesverbalit? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/1154 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për vazhdimin e shërbimeve të varrimit për banorët e Komunës së Malishevës për vitin 2021.

Rahim Morina: Unë një ditë përfaqësuesit e BIK-ut e kam pas në zyre ata po kërkojnë që tani të bëhen pagesat për secilin rast, unë ju thash kërkesën do ta trajtojmë në KPF.

Halil Morina: E dimë që pagesa për shërbimet e varrimit për qytetarë është pritë mire nga qytetarët, kurse për specifikat se si do të vendosim është kuvendi i Komunës që vendose. Si do që të vendoset me raste apo siç ka qenë mirë është mos të ketë keqpërdorime nga askush, sepse kjo është një ndihmë për qytetarët.

Alban Krasniqi: Jam pesimist që ka diskutim kualitativ, por në pyetje janë paratë publike, kur ju kamë thënë se prindi kur me vdekë ato para i kanë keqpërdor, e përkundër një fakti marrëveshjen e keni votuar dhe ju tentoni me ba politikë e jo me marrë vendim për kualitetin dhe shërbimet bile ju e

keni pas votu edhe rritjen për shërbimet qe i kryejnë. Këtu BIKU po vihet në fokus të çështjes e jo qytetari, se përjashtoj kryerjen e shërbimit, por se përjashtoj edhe keqpërdorimin e marrëveshjes. Askush nga nuk duhet të jetë i falshëm ndaj një keqpërdorimi nëse ndodh në shërbim të të vdekurve, ju lus të reflektoni se dikush po ju trason rrugën. Matja e tyre është qysh BIKU e përcakton, e këtu ska ndonjë raport për secilin rast dhe shërbimet e tyre dhe ne nuk mundemi çdo rast me formu komision e meju kërkuar të dhëna, ne ju kemi deleguar menaxhimin e ata duhet mi krye shërbimet sipas procedurave ndaj njerëzve ashtu qysh e përcakton marrëveshja. Kualiteti është shumë i ulët, çarçafi etj. Ne duhet të kemi një raport krahas kërkesës së BIK-ut me shqyrtua pastaj kuvendi e vendos se si.

Muharrem Morina: Kërkesa e BIK-ut ka edhe shku në DSHP, drejtorja e ka sjellë te kryetari, pastaj aj me kërkesë ju ka drejtuar juve, dhe tani ju jeni ata që vendosni .

Alban Krasniqi: Ne duhet një herë me pa marrëveshjen pastaj edhe raportin me shqyrtuar.

Rahim Morina: Ne mund të ju kërkojmë raportin e shpenzimeve për vitin 2019 si dhe deri në muajin Tetor të vitit 2020.

Halil Morina: Atëherë pas debatit e kemi pas formuar një komision, kemi pas hulumtuar dhe shkeljet i kemi pas paraqitur në raport para kuvendit, Biku na ka pas thënë se janë keqkuptuar dhe nuk i kanë pas gjërat të specifikuara, dhe kemi thënë se momentin që vërejmë shkelje, marrëveshja duhet meju shkëputur.

Alban Krasniqi: Ideja është mos me shku në hetime, më mirë është me zgjidhe problemi këtu.

Filloreta Bytyçi: Të kemi një raport, se me herët ka pas dallavere të kaluarën, duhet të kemi raport për secilin, pastaj me shqyrtu a me vazhduar. Pra te kemi pikë e presje për secilin rast të shpenzimeve.

Valon Krasniqi: Te marrëveshja me BIK-un të gjithë i kemi këto ide të përbashkëta për të mirën e qytetarëve, se shkelje ka pas mos te lëshohemi me raste konkrete.

Rahim Morina: Ne ju kërkojmë raportin, le të na vije edhe një herë në komitet.

Raimonda Krasniqi: Nëse deri ditën kur thirret mbledhja e sjellin raportin mirë, nëse jo e leme për mbledhjen tjetër të radhës.

Rahim Morina: Kush jeni qe pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/1155 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike.

Muharrem Morina: Zyrës së kryetarit KEDS ju ka drejtu me kërkesë pasi që ata janë duke zhvendosur disa stabilimente të vjetra për mi vendosur disa stabilimente të reja, si dhe vendosjen e disa trafave nëpër disa fshatra. E për vendosjen e trafave kanë kërkuar qe kuvendi meja nda nda sipërfaqet.

Halil Morina: Çdo investim është i mirëseardhur vetëm se ne duhet te vendosim a meju nda lokacionin me pagese apo si ka qenë deri me tani.

Alban Krasniqi: Ne e dimë që rrjeti i energjisë nëpër fshatra është i dobët, dikund rrezikohet edhe jeta e qytetarëve prej tij, kërkesa është të kemi përmirësim të gjendjes. Tani vendet ku kanë kërku meju dhanë toka në shfrytëzim duhet me pas të dhëna, drejtoritë duhet me na sjellë informata, orto fotot, pastaj vendi ku kanë mu vendosur stabilimentet a paraqet në të ardhmen ndonjë pengesë, pastaj vend ndodhja se ku kanë mu vendosur, një duhet me dite se KEDS i merr veç në shfrytëzim, kurse pronësinë e ka kuvendi komunal, pra komuna e ruan te drejtën që kur donë meja marrë pronën.

Rahim Morina: Kush jeni ra rekomandojmë për kuvend, e kërkesën ju bëjmë drejtorive për informacione shtesë? Unanimisht ishin për.

4. Raporti i Drejtorisë për Urbanizëm, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2020.

Rrahim Morina: Drejtorin e Urbanizmit e kam kontaktuar dhe me ka thënë se materialin ju sjelli në mbledhjen e Kuvendit.

Alban Krasniqi: Kjo praktike po ndodhë vazhdimisht dhe spo kemi çka bëjmë, prapë i qëndrojmë asaj që kemi thënë se duhet mi kushtëzuar dhe asnjë kërkesë e kryetarit mos të futet në rend të ditës deri sa nuk i kemi këto raporte, fundit ky është edhe qëndrimi politik nëse përkrahet nga të tjerët. Ta marrim barrën e llogaridhënies, sepse po ndodh një mish mash nëpër projekte sepse ka pas raste nuk janë fute projekte e punët janë kryer, pastaj kemi votu projekte që s'janë realizuar. Llogaridhënia dhe transparenca duhet me kanë në çdo rast e jo kështu me shpëtuar kokën e drejtorit me pazare. Injorimi i kuvendit në këso raste duhet ta ketë edhe anën tjetër të përgjegjësisë.

Rrahim Morina: Mungesa e bashkëpunimit me Kuvendin po bëhet pengesë.

Halil Morina: Mua ku punoj me ma kerkuar raportin i them prit deri sa të përfundojë viti, sepse pa përfundua një vit s'mundet me pas raport, Urbanizmi sigurisht është në fazën e punimeve dhe fundit ska nevojë dhe s'mund të fshihet asgjë që është publike.

Alban Krasniqi: Te lutem Halil mos ma fyej inteligjencën mua dhe tjerëve, sepse këtu po diskutojmë raportin e një drejtorie e kjo çka thua t'i është mbrojtje e se keqes dhe mos mundoni me mbrojt krimin.

Halil Morina: Ekstremist quhet për mua ai që mendon se veç kur ai mendon e ka mirë, në qofte se lyp raport kur a krye viti 2020 nuk mundemi me thanë keq ose mirë, nëse ka dallavere se përkrahi.

Rrahim Morina: Data 15 nëntor gjithçka përfundon si në pagesa si gjithçka dhe drejtori ka mundur raportin me sjellë.

Alban Krasniqi: Ai që ka obligim me raportin duhet me sjellë raportin, por s'mundet askush mu fsheh mas punëve të këqija e këta vërtet po tallen me kuvendin. Në fshatin Carrallukë fëmijët ecin rrugës sepse ska trotuar ata fëmijë përditë rrezikohen dhe ajo rrugë shkon ka familja e një dëshmori.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë raport për Kuvend? Për ish-in 2, kundër 2, abstenime 2. Rrahim Morina vota ime shkon për rekomandim të raportit.

5. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.

Rrahim Morina: Si çdo vit që kemi formuar komisionin për hartimin e planit të punës edhe këtë vit duhet ta hartojmë planin e punës për vitin që vjen. Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend?

Për ish-in 6 të rekomandohet.

6. Shqyrtimi i draft rregullores për mbrojtjen dhe përkujdesjen e të drejtave të fëmijëve.

Rrahim Morina: Kjo draft rregullore ka qenë në kuvend në e kemi qite për debat publik, e falënderoj Verën për gjithë angazhimin që e ka treguar për organizimin e debatit publik. Tash pas debatit publik gjitha propozimet i ka fute në draft dhe e ka sjellë për miratim.

Kush jeni që me propozimet e debatit publik ta rekomandojmë? Për ish-in 6 unanimisht.

7. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/427 datë:16.11.2020 të parashtruar nga Shoqata Sindikale e Pavarur e Administratës në Malishevë.

Alban Krasniqi: Me qenë se pi paguajnë shujtat për Arsim edhe pa të drejtë, me marrëveshje uroj që deri në miratim të Ligjit kjo qeshtë tani të ndalet, por kërkoj që mos te përdoren standard të dyfishta. Të merret vendim që shujtat tu paguhen njëjtë si në Arsim edhe për shërbyesit civil deri në miratim të ligjit të pagave.

Halil Morina: Kërkesat për shujta për arsim nuk i kemi bërë ne por sindikata e Arsimit.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Për ish-in 6 unanimisht.

Kërkesa nr.12/177 datë:26.10.2020 e parashtruar nga Klubi i futbollit FC Malisheva.

Halil Morina: Me mbështetë sportin është mirë, kemi një klub që po synon suksese të mëdha, kisha kërkuar të përcillet për Kuvend.

Valon Krasniqi: Mirë është ky klub të mbështetet, shuma që kanë kërkuar është e madhe, kërkoj të rekomandohet për kuvend.

Rrahim Morina: Disa herë janë mbështetur klubet e ndryshme.

Alban Krasniqi: Iniciativa e parë ka sjellë ndërtimin e fushës në Mîrushë pra si iniciativa të mëhershme. Sporti është ndihmuar në vazhdimësi, por mos të harrojmë se 700 familje i kemi në asistencë sociale. Kur japim paranë publike mirë është të kemi bazë ligjore, sepse edhe ligji për OJQ-të thotë se një herë në vit mund të ndihmohen.

Valon Krasniqi: Unë kam qëndrim human dhe jam t'i ndihmojmë.

Alban Krasniqi: Ne duhet me pa statusin e këtij klubi për mi ndihmuar, pra drejtoria të na jep sqarime për statusin e klubit, a janë ndihmuar. Klubi ka qenë mirë të menaxhohet nga Komuna

Rrahim Morina: Kush jeni që lidhur me këtë kërkesë të kërkojmë sqarime nga drejtoria për Kulturë. Për ishin 6 unanimit.

Kërkesa nr.02/401 datë: 30.10.2020 e parashtruar nga Klubi Besa.

Rrahim Morina: Kush jeni që lidhur me këtë kërkesë të kërkojmë sqarime nga drejtoria për Kulturë. Për ishin 6 unanimit.

Kërkesa e Agjencioneve të sigurimeve nr.02/424 të datës: 12.11.2020

Alban Krasniqi: Ajo pjesë është tokë publike, janë disa montazhe të ndërtuara aty e ne s'kemi çka merremi hiq me këtë kërkesë.

Rrahim Morina: Kush jeni kjo kërkesë të përcillet për Drejtorinë për Urbanizëm dhe Inspektorat? Unanimit ishin për.

Kërkesa nr.02/425 të datës:12.11.2020 e parashtruar nga pronari i ISP BROADCAST SH.P.K

Rrahim Morina: Në duhet parashtruesit të kësaj kërkesë t'i japim përgjigje se Komuna e Malishevës deri me tani nuk ka subvencionuar asnjë biznes, pasi që nuk ka mjete financiare për këtë qëllim. Nëse ndonjëherë do të subvencionojë kompanitë e dëmtuara gjatë pandemisë COVID-19 duke u bazuar në kritere, do të ketë parasysh edhe kërkesën tuaj.

Rrahim Morina: Kush jeni t'i përgjigjemi me këtë njoftim? Unanimit ishin për.

I kemi disa kërkesa për ndihma financiare.

Alban Krasniqi: Lidhur me kërkesat për ndihmë financiare, unë mendoj se çdo Informacion i pa saktë duhet të ketë secili parashtrues edhe përgjegjësinë ose te jetë edhe subjekt i ndjekjes penale.

Rrahim Morina: Po ju lexoj kërkesat.

kërkesa nr.02/398 datë: 23.10.2020 nga Valon Paqarizi nga fshati Dragobil

Rrahim Morina: Kush jeni ta ndihmojmë për shërim me 800 euro? Unanimit ishin për

kërkesa nr.02/400 datë: 30.10.2020 Bajram Zulfaj nga fshati senik

Rrahim Morina: Kush jeni ta ndihmojmë për shërim me 800 euro? Unanimit ishin për.

kërkesa nr.02/432 datë: 17.11.2020 nga Urim Muhaxheri nga fshati Lladroviq

Rrahim Morina: Kush jeni ta ndihmojmë për shërim me 500 euro? Unanimit ishin për

kërkesa nr.02/433 datë: 18.11.2020 nga Zize Gegaj nga fshati Lladroc, për trajtim shëndetësor të vajzës së sajë Fatlinda Gegaj.

Rrahim Morina: Kush jeni ta ndihmojmë për shërim me 800 euro? Unanimit ishin për.

kërkesa nr.02/388 datë: 20.10.2020 Isuf ulluri për shërim të djalit të tij, Rigon Ulluri.

Rrahim Morina: Kush jeni ta ndihmojmë për shërim me 800 euro? Unanimit ishin për.

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00

Procesmbajtësi

Naim Avdiqaj jur. i dip

